



НАРОДНА БАНКА НА РЕПУБЛИКА МАКЕДОНИЈА

Në mbështetje të nenit 47, paragrafi (1), pika 6) të Ligjit të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 158/10, 123/12, 43/14, 153/15 dhe 6/16) dhe nenit 103, paragrafi (1), nënpika 3) të Ligjit të Bankave ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 67/07, 90/09, 67/10, 26/13, 15/15, 153/15 dhe 190/16), Këshilli i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë mori:

VENDIM

për ndryshimin e Vendimit për trajtimin kontabël dhe rregullues të mjeteve të marra në bazë të kërkesave të papaguara ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 26/17)

1. Në Vendimin për trajtimin kontabël dhe rregullues të mjeteve të marra në bazë të kërkesave të papaguara ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 50/13), në pikën 6), paragrafi (2) ndryshon si më poshtë:

"Rezerva e rivlerësimit e paragrafit (1) të kësaj pike mund të lirohet për pjesën që:

- i referohet mjeteve të shitura të konfiskuara për të cilat është paraqitur më parë shuma e rezervës së rivlerësimit; ose
- është e barabartë me shumën e fitimit pas tatimit, për të cilën Asambleja e Bankës mori vendim për shpërndarjen e saj në rezervën e përgjithshme të detyrueshme (fondi rezervë i përgjithshëm) ose në fitimin e pashpërndarë të mbajtur, të cilat plotësojnë kushtet për t'u përfshirë në kapitalin bazë të rregullt, në përputhje me rregulloren e Bankës Popullore për metodologjinë për përcaktimin e mjaftueshmërisë së kapitalit".

2. Ky vendim hyn në fuqi ditën e botimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë.

V nr. 02-15/II-5/2017
27 shkurt 2017
Shkup

Guvernatori
dhe kryesuesi
i Këshillit të Bankës Popullore të
Republikës së Maqedonisë
Dimitar Bogov